



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 21

Datë: 12. 07. 2023. Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ.

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nr. 20/2023 të KQZ-së**
- 3. Raportet e Këshillave të KQZ-së**

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratim i rishikimit të Planit të punës për vitin 2023

- 4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Buxhetit për vitet 2024-2026**
- 5. Të ndryshme**

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Në fillim të mbledhjes, kryetari Kreshnik Radoniqi paraqiti agjendën e mbledhjes. Nuk pati vërejtje, propozime apo, ngjashëm. Dhe pastaj, me vota unanime u miratua rendi i ditës.

Në vazhdim, anëtarët e KQZ –së, miratuan procesverbalin nr. 20/2023 të KQZ-së.

2. Raportet e Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratim i rishikimit të Planit të punës për vitin 2023

Arianit Elshani: E kemi shqyrtuar kërkesën e Sekretariatit sipas planit të punës për rishikimin e planit të punës, dhe ne kemi miratuar në parim kërkesën e sekretariatit për zgjatjen e afateve për të përfunduar disa aktivitete të planifikuara. Kemi refuzuar disa kërkesa, sepse koha e kërkuar nuk korrespondon me aktivitetet e KQZ-së dhe ne kemi kërkuar që të rriten kapacitete e angazhimit që të kryhen punët.

Bëhet fjalë për pesë kërkesa. (Z. Elshani, e paraqiti një raport të zgjeruar nga takimi në KOZ, dhe pasqyroi kërkesat dhe rekomandimet - disa të afatizuara, disa u janë zgjatur afatet...)

Sami Kurteshi, këtu janë disa aktivitete që duhet të shtyhen, por nuk po e dimë arsyen. Veç na tregoni arsyet pse nuk janë realizu, pse janë shty..!

Arianit Elshani, shpjegoi arsyet veç e veç se pse janë bërë shtyrjet e përfundimit të rregulloreve, arsyet e shtyrjes, arsyet e “kohës” së mos realizimit, dhe pastaj “arsyet” e shtyrjes tani etj. Përfshirë, edhe “historiken e zgjedhjeve”...

Ilir Gashi, tha se meqë është rekomandim i KOZ-it për shtyrje, sigurisht aty është vlerësue gjendja dhe s’kam ndonjë dyshim...Sa i përket dokumentit “Historiku i zgjedhjeve”, unë kam mundësi të ofroj shumë materiale qysh nga e kaluara, statistika zgjedhore gjë që mund të shpejtohet puna...

Në fund, anëtarët e KQZ –së miratuan 10 vota për, “...rishikimin e planit të punës për vitin 2023”.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Buxhetit për vitet 2024-2026

1. **Gordana Llaban:** Sot, kemi mbajtur takimin e tetë. Në këshill, e kemi shqyrtuar pikën e planit të buxhetit për vitet: 2024-2026. Nuk do t'i lexoj të gjitha, por kemi tre kode: "14 – 100", ky kod përshinë programin e Sekretariatit, dhe përfshinë shpenzimet operative "14 – 200" përfshinë programin zgjedhorë ky hyjnë aktivitetet e rregullta të lidhura me proceset zgjedhore. Dhe kodi "10 – 400" që përfshinë mbështetjen e partive politike, subvencionim që kalon përmes KQZ-së.

KQZ, i janë ndarë mjetet mbi bazën e këtyre "tri linjave" në vlerë prej: 6, 397, 174 euro. Në vazhdim, znj. Llaban e pasqyro raportin e mjeteve për secilën linjë buxhetore. Po ashtu, ajo e pasqyro një raport të veçuar për vitin 2024, po sipas tri fondeve: programin e mbështetjes së partive politike (kodi: 10-400), Sekretariati (kodi: 14-100), dhe programi zgjedhor (14-200).

Vlera e tërësishme e mjeteve, është: 10, 785, 420 euro: mbi 4 milion e 846 mijë euro më shumë se buxheti i planifikuar për vitin 2024. Kjo, për arsye se viti 2024, është vit zgjedhor. (Znj. Llaban, raportoi në shifra të ndara për secilin shpenzim - program, në bazë të linjave – kodeve buxhetore).

Ilir Gashi, përmendi "makinat" që janë të planifikuara nga buxheti, makinat që jemi përcaktuar t'i marrim me qira...

Burim Ahmetaj, tha se autoriteti i AQP-së ka dhënë njoftimin për dhënien e kontratës: fjala është për veturat me qira, e ku është edhe kërkesa jonë. Zyrtarisht, nuk kemi ende njoftim...

Sami Kurteshi, pyeti se edhe sa rregullore kanë mbetur për tu përfunduar...?

Burim Ahmetaj: Kanë mbetur edhe 5-6 rregullore, por besoj që kryesuesi i KOZ-it mund të ketë më shumë njohuri...

Arianit Elshani: Ne, edhe u dakorduam që nga e hëna të fillojmë me shqyrtimin e rregulloreve, me ato që i kemi shtyrtue por ende si kemi përfundue, dhe me rregulloret që fare s'i kemi shqyrtue...! Janë rregullore e fushatave, ato që lidhen me sekretariatit etj. Më pastaj, u diskutua rreth komunikimit, organizimit dhe aspekteve të tjera në mënyrë që të, fillohet me shqyrtimin dhe hartimin e detajuar dhe final të rregulloreve.

Diskutuan dhe shtruan pyetje: Arianit Elshani, Sami Kurteshi, Kreshnik Radoniqi, Burim Ahmetaj, Ilir Gashi.

2. Të ndryshme

